



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

### SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të Ligjit Nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” I ndryshuar, VKM nr. 243 datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Këshilli i Qarkut Shkodër shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

*Specialist i planifikimit dhe zhvillimit (social)-*

*Drejtoria e Zhvillimit te Politikave Rajonale dhe e Bashkëpunimit me Jashtë*

**Kategoria III-b**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për:**

**LEVIZJE PARALELE**

**29 Mars 2021**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL**

**03 Prill 2021**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- a) Hartimi i Planit në lidhje me Planifikimin dhe Zhvillimin Social në qarkun Shkodër, ku të përcaktohen dhe detyrat e çdo institucioni, në bazë e për zbatim të ligjit, duke përfshirë njëkohësisht dhe institucionet jo-publike;
- b) Mbajtja e një baze të dhënash të saktë për të pasur një pasqyrim të situatës aktuale të fëmijëve në situatë rruge në qarkun Shkodër;
- c) Hartimi dhe zbatimi i politikave (nën drejtimin e eprorit për hartimin e politikave) standardeve/ marrëveshjeve/ procedurave etj, për të ndihmuar individët (fëmijë apo të rritur), familje, grupe të ndryshme shoqërore dhe, komunitete të caktuara, në nevojë, që të zhvillojnë aftësitë dhe burimet për të cilat ata kanë nevojë për të realizuar dhe për të rritur funksionimin social të tyre;
- d) Organizon dhe zbaton politikat për t'iu përgjigjur nevojave të tjera sociale të qarkut Shkodër për çështje të tilla, si mos-diskriminimi racor, fetar, barazia gjinore, dhe lufta kundër varfërisë.
- e) Përgjegjës për planifikimin e mundësive të ofrimit të shërbimit të specializuar shtesave në nevojë të sipërcituara.
- f) Drejtimi i fushatave sensibilizuese (nëpërmjet fletëpalosjeve, posterave dhe materialeve ndihmëse) për tema të tilla si: Stresi dhe Ankthi, Dhuna ndaj Gruas, HIV-AIDS, Droga, Duhani, Alkooli, Planifikimi Familjar, Aborti etj;
- g) Rrjetëzim të kapaciteteve dhe burimeve të aktorëve lokal kryesorë në shërbim të shtesave të ndryshme;
- h) Do të jetë përgjegjës për funksionimin e njësisë së mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në qark;
- i) Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari i institucionit apo eprori.

## **1- LËVIZJA PARALELE**

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### **KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë me arsim të lartë, në fushën e zhvillimit social-ekonomik dhe të edukimit
- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-b;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të ketë eksperiencë dhe përvojë pune, të paktën deri në 5 vjet
- Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, aftësi dalluese në punën në grup
- Të mos jenë marrë masa disiplinore të parashikura në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”
- të ketë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore të organizimit dhe funksionimit të organeve të vetëqeverisjes vendore,

## **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetë-deklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dorëzimi i dokumenteve për lëvizjen paralele duhet** të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Këshilli i Qarkut Shkodër / Njësia e Burimeve Njerezore, brenda afetit të shpallur në njoftim.

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në filluar pas dates së mbarimit të dorëzimit të pasqyruar në njoftim, Njësia e Burimeve Njerezore, në Këshillin e Qarkut Shkodër, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të lëvizjes paralele si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së lëvizjes paralele do të njoftohen individualisht nga Njësia e burimeve njerezore, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

## FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

### ***Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:***

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- d- Kodi Familjes
- e- Kodi i drejtrwsw pwr tw mitur
- f- Ligji nr. 121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- g- Ligjit nr.18/2017, “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- h- VKM nr. 499 datë 29.8.2018 “ Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit
- i- VKM 578 datë 3.10.2018 “ Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimit dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”,
- j- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët për dokumentacionin e dorëzuar do të vlerësohen në total me **40 pikë** të ndara:

- a- 20 pikë për përvojën,
- b- 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën,
- c- 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**

## DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njesia e burimeve Njerezore në Këshillin e Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Burimeve Njerezore për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

### II - PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

*Vetëm në rast të përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant ,ky pozicion është i vlefshëm për procedurën e pranimit në shërbimin civil nëpërmjet një konkurrimi të hapur.*

#### **Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kërkesat e posaçme:**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Të jetë me arsim të lartë, në fushën e zhvillimit social-ekonomik dhe të edukimit  
Të ketë mbi 1 vit përvojë pune;  
Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter  
Të ketë përvojë në administratën publike  
Të zotërojë kualifikime dhe/ose certifikime profesionale të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze, (të certifikuar) si dhe një gjuhë tjetër të B.E.

## DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

### Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor) Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetë-deklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

**Dorëzimi i dokumenteve duhet** të bëhet me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, (pranë protokoll arshives, Këshilli i Qarkut Shkodër), rruga 28 Nëntori nr. 4001 Shkodër, brenda datës së lajmeruar në njoftim.

### REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar pas dates së perfundimit të njoftimit Njesia e Burimeve Njerezore në Këshillin e Qarkut Shkodër do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit për kategorinë ekzekutive në shërbimin civil, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Burimeve Njerezore të Këshillit të Qarkut Shkodër, për shkaqet e mos-kualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

#### Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
- b- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- d- Kodi Familjes

- e- Kodi i drejtrësisë për të mitur
- f- Ligji nr. 121/2016 “ Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- g- Ligji nr.18/2017, “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- h- VKM nr. 499 datë 29.8.2018 “ Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit
- i- VKM 578 datë 3.10.2018 “ Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimit dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”,
- j- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- a- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën;

**MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët e shpallur fitues nga verifikimi paraprak do të vlerësohen në lidhje me:**

- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e të trajnimeve të lidhura me fushën;
- Vlerësimin me shkrim;
- Intervistën e strukturuar me gojë;

**Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:**

- Për vlerësimin jetëshkrimin (CV) të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të experiences e të trajnimeve, të lidhura me fushën: 15pikë
- Për intervistën e strukturuar me gojë: 25pikë
- Për vlerësimin me shkrim: 60pikë.

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Prokurimeve dhe Shërbimeve të Brendshme në Këshillin e Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të internetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Prokurimeve dhe Shërbimeve të Brendshme, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

